



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrim Evropian.
Mbledhja nr. 43.
Prishtinë, më 23.09.2022, në orën 10:00.
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Agon Batusha, Fjolla Ujkani, Shqipe Isufi, Driton Hyseni dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Arbëresh Kryeziu Hyseni, Fridon Lala, Elmi Reçica, Blerta Deliu Kodra dhe Branisllav Nikoliç.

Nga stafi mbështetë i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Pjesëmarrësit tjerë: asistent nga grupet parlamentare, LVV, LDK dhe PDK dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi - Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18.07.2022, 21.07.2022 dhe 28.07.2022;
3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror 2022;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-109 për kompensimin e viktimave të krimit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18.07.2022, 21.07.2022 dhe 28.07.2022

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2022;

Kryetarja pyeti anëtarët se a pajtohen me raportin e punës për sesionin pranveror dhe hapi debatin.

Time Kadrijaj, tha se pajtohet me raportin e punës, por propozoj që në një nga mbledhje e radhës të shqyrtohet Plani vjetor i punës dhe nëse ka propozime eventuale të plotësohet.

Kryetarja, tha se e ka paraparë të njëjtin dhe do ta shqyrtojnë në një të mbledhjet.

E hodhi në votim Raportin dhe konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti i punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2022.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-109 për kompensimin e viktimave të krimit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, tha se *Projektligji nr. 08/L-109* për kompensimin e viktimave të krimit, ka për qëllim të rregullojë funksionimin e Programit për kompensim të viktimave të krimit dhe procedurave që lidhen me këtë program. Legjislacioni i BE-së në fushën e veprimit të këtij projektligji përbëhet nga legjislacioni primar dhe sekondar. Si përfundim ky Projektligji nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Hapi debatin dhe e hodhi në votim projektligjin së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional.

Pas votimit kryetarja konstatoj se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-109 për kompensimin e viktimave të krimit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Të ndryshme

Pasi nuk kishte çështje për diskutim në këtë pikë Kryetarja e mbylli mbledhjen.

Takimi përfundoj në orën 10:50.

Rrezarta Krasniqi,

Kryetare e Komisionit

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit